



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 98

Tiranë – E premte, 1 korrik 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13735, datë 27.6.2022	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 12437
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 442, datë 29.6.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 525, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve”..... 12437
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 29.6.2022	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njesisë Administrative Tiranë, të pasurive 7/12 dhe 7/13, zona kadastrale 8210, dhe për një shtesë në vendimin nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar..... 12437
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 449, datë 29.6.2022	Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë dhe të fondeve buxhetore në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2022..... 12442
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 29.6.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 348, datë 29.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”..... 12442
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 29.6.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 317, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për përfaqësuesit e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale’”.... 12443
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 454, datë 29.6.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 594, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1, shtesat, pjesa lindore’, Vlorë”, të ndryshuar..... 12443
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 455, datë 29.6.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 28, datë 17.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, të ndryshuar..... 12444

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.6.2022	Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.....	12445
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 29.6.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, të ndryshuar	12450
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 29.6.2022	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë së paluajtshme nr. 2/973-N27, në zonën kadastrale 8591.....	12450
	Korrigjim gabimi material, në vendimi e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, “Mbi miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe afatet, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 196, datë 20.12.2021.....	12454

**DEKRET**

Nr. 13735, datë 27.6.2022

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, e 20, dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Arsemin Bashkim Xhaferaj (Haznedari)
2. Fatjona Dashnor Skënderi (Skenderi)
3. Suada Teki Tane (Mukja)
4. Geralda Kozma Moulas (Toli)
5. Dritan Kristaq Gjata
6. Armela Ilirjan Mërtiri
7. Brunilda Agur Buhali (Brahushaj)
8. Silvana (Silvanë) Bozho Dogandžić (Peroja/
Kontiq)
9. Sefer Jorgo Rrokaj
10. Marin Gjini Ndrepepa
11. Vasian Anastas Tane
12. Avelyn Vasian Tane
13. Benjamin Vasian Tane
14. Hekuran Esat Xhaferaj
15. Blerina Ndue Morina (Koca)
16. Besa Shkëlzen Ahmeti
17. Alda Artan Hoti (Puka)
18. Julian Enver Gjini
19. Silvana Rifat Lubisch (Daçi)
20. Gerta Novrus Çinari (Çinari/Selamaj)
21. Isabel Kreshnik Çinari (Çinari)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 442, datë 29.6.2022

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
525, DATË 22.9.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË
SHTETËRORE TË MINISTRI TË
SHTETIT PËR STANDARDET E
SHËRBIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 5, të vendimit nr. 525, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1 Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve është përgjegjës për përmbushjen e parimeve të qeverisjes së mirë.”.

2. Ngarkohet ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

VENDIM

Nr. 444, datë 29.6.2022

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI
TË BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË
ADMINISTRATIVE TIRANË, TË
PASURIVE 7/12 DHE 7/13, ZONA
KADASTRALE 8210, DHE PËR NJË
SHITESË NË VENDIMIN NR. 219,
DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “ç”, e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të pasurive 7/12 dhe 7/13, zona kadastrale 8210, sipas formularëve dhe planeve të rilevimit që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t'u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik.

2. Pasuritë e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohen listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e

dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës", të ndryshuar.

3. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Identifiktori: Albana Hoxha (përfundimtar) Raif Halidini (Specialist)
Ervin Nikolla, (Drejktori)
Supervizori Alban Dokushi, Drejtor (Drejtorja e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit)

Approvi: Erion Veliaj (Kryetar)

Bashkia Tiranë

Fusha e përdorimit të Pronës: Zhvillim Ekonomik

Nr	A			B			C			
	Zona Kadastrale Indeks i Hartes	Nr Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip Totale e Prones (m2)	Nga Sip Totale: Sa Nderese (m2)	Funksion per te cilin perdoresh Prona	Institucioni / Enti me perqeljesi administrative	Institucioni / Enti perdoresh Statusi juridik i perdoreshit (Shënimet te vecanta)	
1	8240 Tr S-5	4/289	Tuall	Rr Piro Gogo	434.77	6	8	9	10	11
2	8240 Tr S-5	4/110	Tuall	Rr Sabaudin Gabrani	434.75		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.5, fq. 124
3	8240 Tr S-5	4/555	Tuall	Rr Sabaudin Gabrani	621.98		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.4, fq. 195
4	8240 Tr S-5	4/553	Tuall	Rr Sabaudin Gabrani	585		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.10, fq. 84
5	8240 Tr S-5	4/271	Tuall	Rr Sabaudin Gabrani	94.05		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.10, fq. 82 vijon nga v.5, fq. 108



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

6	8240 Tr S-5	4/275	Truall	Rr. Sabaudin Gabrani	553.25		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.5, fq 111
7	8240 Tr S-5	4/273	Kanal	Rr. Sabaudin Gabrani	163.66		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.5, fq 109
8	8240 Tr R-5	4/559	Truall	Rr. Sabaudin Gabrani	75.77		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.10, fq 88 vijon nga v.4, fq 189
9	8240 Tr R-5	4/557	Truall	Rr. Sabaudin Gabrani	54.77		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.10, fq 86 vijon nga v.4, fq 188
10	8240 Tr R-5	4/561	Truall	Rr. Sabaudin Gabrani	429.26		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.10, fq 90 vijon nga v.10, fq 10
11	8210 Tr K-5	7/12	Rruge	Rr. Dritan Hoxha	301.1		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.7, fq 214
12	8210 Tr K-5	7/13	Truall	Rr. Dritan Hoxha	914.09		Zhvillim Ekonomik	Bashkia	Bashkia	shtet, v.26, fq 50



[Handwritten signature]



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATE 18.12.2020		QELIMI: TRANSFERIM		
VENDNDODHJA BASHKIA: TIRANË	DVASHK/ZVASHK : TIRANË VERI	ZONA KADASTRALE: 8210	NUMRI PASURISE: 7/12	INDEX HARTE: TR-K-5		
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: RRUGË	SIP.PASURISE= 301.10 M ²	SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= _____ m	NUMRI KATEVE _____	NUMRI PEMEVE _____		
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE						
X= 482091.61 Y= 4578245.06					X= 482187.54 Y= 4578245.06	
X= 482091.61 Y= 4578170.15		SH 1:500			X= 482187.54 Y= 4578170.15	
SISTEMI KORDINATIV SIPAS K.RR.GJ.SH 2010						
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1				VERI PAS 7/386		
2				LINDJE PAS 7/13, 7/18, 7/19, 7/20		
3				JUG PAS 7/544		
4				PERENDIM PAS 7/69, 7/567, 7/568		
REALIZOI PER BASHKINË TIRANË EMRI: RAIFF HALIDINI SPECIALIST ING. TOPOGRAF: REALIZOI PER ASHK KONFIRMOI TEKNOLOGJIA E MATJEVE: ORTOFOTO E MATJE DISTANCASH PERCAKTIMI KUFIRIT: SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET						



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI: SHTET		DATE 18.12.2020		QELIMI: TRANSFERIM		
VENDNDODHJA BASHKIA: TIRANË DVASHK/ZVASHK : TIRANË VERI ZONA KADASTRALE: 8210 NUMRI PASURISE: 7/13 INDEX HARTE: TR-K-5 TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE= 914.09 M ² SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= _____ m NUMRI KATEVE _____ NUMRI PEMEVE _____						
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE						
X= 482091.61 Y= 4578245.06					X= 482187.54 Y= 4578245.06	
X= 482091.61 Y= 4578170.15		SH 1:500 SISTEMI KORDINATIV SIPAS K.RR.GJ.SH 2010			X= 482187.54 Y= 4578170.15	
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1				VERI PAS 7/386		
2				LINDJE PAS 7/291, 7/14, 7/294		
3				JUG PAS 7/18		
4				PERENDIM PAS 7/12		
REALIZOI PER BASHKINË TIRANË EMRI: RAIF HALIDINI SPECIALIST ING. TOPOGRAF REALIZOI PER ASHK KONFIRMOI TEKNOLOGJIA E MATJEVE: ORTOFOTO E MATJE DISTANCASH PERCAKTIMI KUFIRIT: SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET						

**VENDIM****Nr. 449, datë 29.6.2022**

**PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ORGANIKË DHE TË
FONDEVE BUXHETORE NË NJËSITË
E QEVERISJES QENDRORE,
PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12 e 17, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të sistemit të institucioneve të tjera qeveritare (Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm), për vitin 2022, reduktohet me 8 (tetë) veta, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të institucioneve të tjera qeveritare në 1 355 (një mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) punonjës.

2. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2022, shtohet me 8 (tetë) veta për aparatin e Ministrisë së Brendshme, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të Ministrisë së Brendshme në 15 119 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë) punonjës.

3. Në programin 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, për Ministrinë e Brendshme, shtohet fondi prej 11 936 791 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekësh, i ndarë në zërin “Shpenzime korrente”, 11 436 791 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë dhe në zërin “Shpenzime për investime”, 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për vitin 2022, për aparatin e Ministrisë së Brendshme.

4. Në programin 01150 “Shërbime të tjera”, për institucione të tjera qeveritare (Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm), reduktohet fondi prej 11 936 791 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekësh, i ndarë në zërin “Shpenzime korrente”, 11 436 791

(njëmbëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë, dhe në zërin “Shpenzime për investime”, 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për vitin 2022, për Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

5. Numri i përgjithshëm i punonjësve organikë buxhetorë nuk ndryshon.

6. Ngarkohen Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

VENDIM**Nr. 452, datë 29.6.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 348, DATË 29.4.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT,
KRITERET DHE RREGULLAT PËR
ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES
NËPËRMJET VETËPUNËSIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, të vendimit nr. 348, datë 29.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 10 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i. në shkronjën “a”, numri “një” zëvendësohet me “dy”;

ii. shkronja “c” shfuqizohet.

b) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Përzgjedhja e anëtarëve të këtij komisioni bëhet nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-së.”.

c) Kudo në vendim, fjalët “aplikues/aplikim” zëvendësohen me “kërkues/kërkësë”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 453, datë 29.6.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 317, DATË 31.5.2018, TË KËSHILLIT MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 195, 198 dhe 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në përmbajtje të rregullores “Për përfaqësuesit e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”, bashkëlidhur vendimit nr. 317, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në tekst, fjalët “licencimi”, “të licencohet”, “licencimin”, “licencimit” dhe “licencën” zëvendësohen, përkatësisht, me “certifikimi”, “të certifikohet”, “certifikimin”, “certifikimit” dhe “certifikatën”.

2. Pika 3, e nenit 2, shfuqizohet.

3. Në pikën 10, të nenit 5, fjalët “... komisioni i licencimit ...” zëvendësohen me “... komisioni i vlerësimit ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 454, datë 29.6.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 594, DATË 31.8.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘VIJA BREGDETARE E QYTETIT TË VLORËS, FAZA 1, SHTESAT, PJESA LINDORE’, VLORË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 594, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera e përgjithshme e shpronësimit të pronarëve prej 356 185 311.76 (treqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh zëvendësohet me 371 116 970.26 (treqind e shtatëdhjetë e një milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë pikë njëzet e gjashtë) lekë.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, përballohen, si më poshtë vijon:

a) Vlera prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban;

b) Vlera prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.”.

c) Tabelave bashkëlidhur vendimit i shtohet edhe tabela 2/C, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës,



Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 594, DATË 31.8.2016, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “VIJA BREGDETARE E QYTETIT TË VLORËS, FAZA 1, SHITESAT, PJESA LINDORE”, VLORË, TË NDRYSHUAR

Tabela 2/C

Nr.	Bashkëpronarët			TË DHËNAT (mbi pasurinë, sipas ASHK)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË			VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.	Lloji pas.	Sip. totale (m²)	Shpronësim tokë “truall”				
					Pas.			Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)		
1	Safete Alim Sadiku, Liri Alim Sadiku, Gjyshi Latif Sadiku, Gezim Alim Sadiku, Kujtim Sadiku, Diana Çane Sadiku, Erion Flamur Sadiku, Flodian Flamur Sadiku, Leko Rushit Sadiku, Algert Sabri Sadiku, Lorenc Sabri Sadiku			8602	40/291	Truall	185	119.50	10,903	1,302,908.50	1,302,908.50	Konfirmuar nga ASHK DV Vlorë
2	Safete Alim Sadiku, Liri Alim Sadiku, Gjyshi Latif Sadiku, Gezim Alim Sadiku, Kujtim Sadiku, Diana Çane Sadiku, Erion Flamur Sadiku, Flodian Flamur Sadiku, Leko Rushit Sadiku, Algert Sabri Sadiku, Lorenc Sabri Sadiku			8602	40/79	Truall	1,893	1,250	10,903	13,628,750	13,628,750	Konfirmuar nga ASHK DV Vlorë
Vlera totale								1,369.5	10,903	14,931,658.50	14,931,658.50	

Shënime

1. Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

VENDIME
Nr. 455, datë 29.6.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 28, DATË 17.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË MENAXHIMIT TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, me

propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 28, datë 17.1.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë hyrëse, fjalët “... z. Artan Shkreli, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ...” zëvendësohen me “... z. Ermal Nufi, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ...”.



2. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:
“a) Z. Etugert Llazi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 456, datë 29.6.2022

**PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE PËR
VENDOSJEN E DETYRIMIT TË
SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË
ZBATOHEN NDAJ TË LICENCUARVE
NË SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË CILËT USHTROJNË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT,
TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES DHE
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimet Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe nr. 620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përbalimin e parandalimin e saj”, të ndryshuar, shfuqizohen.

3. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

KUSHTET
**PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË
SHËRBIMIT PUBLIK, QË DO TË
ZBATOHEN NDAJ TË LICENCUARVE NË
SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
CILËT USHTROJNË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT, TRANSMETIMIT,
SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT ME
ENERGJI ELEKTRIKE**

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

2. Ky vendim është hartuar në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 2
Objekti

1. Detyrimi i shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike vendoset duke marrë në konsideratë interesin publik në ushtrimin e këtij aktiviteti, për kushtet që lidhen me:

- a) sigurinë e furnizimit;
- b) cilësinë e shërbimit;
- c) tarifat dhe çmimet për klientët që përfitojnë nga detyrimi i shërbimit publik;
- ç) mbrojtjen e mjedisit;
- d) mbrojtjen e konkurrencës;
- dh) burimet e rinovueshme të energjisë;
- e) eficiencën e energjisë;



ë) çdo rrethanë tjetër që ndikon në interesin publik;

f) ndryshimet klimaterike.

2. ERE vendos detyrimet specifike të shërbimit publik të një të licencuari në kryerjen e ndonjë prej aktiviteteve të sektorit të energjisë, të përmendura në pikën 1, të nenit 1, të këtij vendimi.

3. Çdo detyrim i shërbimit publik, i vendosur nga ERE, do të përfshihet në termat dhe kushtet e licencës së të licencuarit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në rregulloren përkatëse të kushteve të licencimit, të miratuar nga ERE.

4. Të licencuarit, licencat e të cilëve përfshijnë detyrimet e shërbimit publik, duhet të marrin të gjitha masat, në mënyrë që të përmbushin detyrimet e shërbimit publik, në përputhje me këtë vendim.

Neni 3

Përkufizime

1. Çdo term i përdorur në këtë vendim ka të njëjtin kuptim me përkufizimet e termave të dhëna në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Në këtë vendim, fjalët “...i licencuari përkatës...” nënkuptojnë një të licencuar që kryen aktivitetet e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes ose furnizimit të energjisë elektrike.

3. Në këtë vendim, fjalët “klient universal”, nënkuptojnë klientët fundorë, të cilët furnizohen mbi bazën e Shërbimit Universal të Furnizimit, si detyrim i shërbimit publik, me çmime të rregulluara, të miratuara nga ERE.

4. Në këtë vendim, fjalët “tepricë nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë” është sasia e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme, që tejkalon sasinë e pambuluar të humbjeve totale mujore në rrjetin e shpërndarjes, sipas bilancit energjetik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë.

Neni 4

Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik

1. Detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari vendoset nga ERE, në mënyrë transparente, jodiskriminuese, duke mos penguar hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe të drejtën

e furnizuesve të tjerë të energjisë elektrike për të furnizuar klientët në Republikën e Shqipërisë.

2. ERE duhet të argumentojë që vendosja e detyrimit publik është e domosdoshme, jokufizuese, proporcionale dhe e nevojshme.

3. Detyrimi i shërbimit publik për të licencuarin vendoset duke vlerësuar kapacitetin teknik, financiar e organizativ të tij dhe duhet të konsiderojë, nëse e njëjta shoqëri po ofron shërbimin publik në të njëjtën zonë apo kategori klientësh, në momentin e vendosjes së këtij detyrimi.

4. Vendimi për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik duhet të:

a) përcaktojë qartë detyrimet, të cilat duhet të kryhen nga i licencuari;

b) përcaktojë qartë të licencuarit e energjisë elektrike, të cilëve u është vendosur detyrimi i shërbimit publik, kur detyrimi i shërbimit publik vendoset mbi një ose më shumë subjekte të licencuara, që ushtrojnë aktivitet në sektorin e energjisë elektrike;

c) specifikojë të drejtat e veçanta të caktuara për të licencuarin, duke arsyetuar se pse ato janë të nevojshme;

ç) përcaktojë kategorinë e klientëve, territorin dhe periudhën për të cilën është vendosur detyrimi i shërbimit publik;

d) shoqërohet me një efekt vlerësimi në lidhje me tregun, cilësinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë;

dh) identifikojë kostot e të licencuarit, ndaj të cilit do të vendoset detyrimi i shërbimit publik;

e) përcaktojë një mekanizëm transparent dhe jodiskriminues për mënyrën se si duhet të mbulohen këto kosto, nëse kostot nuk mbulohen nga tarifa e miratuar.

5. Në rast të vendosjes së detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari, të cilit i shkaktohen kosto shtesë, që nuk janë përfshirë në tarifën e përcaktuar nga ERE, i licencuari do të kompensohet financiarisht apo në formë tjetër, në përputhje me pikën 8, të nenit 47, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

6. I licencuari nuk ka detyrim të shërbimit publik për sigurimin e shërbimit të energjisë elektrike në një zonë ku nuk ofrohet shërbimi në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përveç



zonave të cilat janë pjesë e planit rregullator, të miratuar sipas legjislacionit për planifikimin e territorit dhe zhvillimit.

7. Ky vendim është i zbatueshëm edhe për përballimin e situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, sipas nenit 90 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

PJESA II DISPOZITA TË VEÇANTA PËR DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK

Neni 5

Detyrimi i Shërbimit Universal të Furnizimit

1. Shërbimi Universal i Furnizimit është një detyrim i shërbimit publik, që i vendoset Furnizuesit të Shërbimit Universal, i cili siguron të drejtën e furnizimit me energji elektrike për një kategori të caktuar të klientëve, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një cilësi të caktuar të furnizimit, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.

2. Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen nga shteti (shoqëria publike e prodhimit). Shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për furnizimin e klientëve universalë, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

3. Për qëllime të furnizimit me të gjitha sasi të nevojshme për nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal, shoqëria publike e prodhimit, përpos shfrytëzimit të aseteve gjeneruese në pronësi, ka të drejtë që sipas nevojës, të kontrakttojë asete gjeneruese të energjisë, të shkëmbejë/të depozitojë energji, të kryejë transaksione shitblerjeje energjie në tregun e lirë apo të lidhë kontrata afatgjata

shitblerjeje të energjisë. Rregullat për transaksionet e energjisë në tregun e lirë dhe lidhjen e kontratave afatgjata të shitblerjes së energjisë, miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

4. Ndërmjet Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe shoqërisë publike të prodhimit, negociohet kontrata, e cila miratohet nga ERE dhe nënshkruhet nga palët. Në këtë kontratë përcaktohet sasia e energjisë së nevojshme për furnizimin e të gjithë klientëve universalë. Shoqëria publike e prodhimit, në bazë të kontratës, lëshon ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal çdo muaj faturën për sasinë e energjisë elektrike, sipas çmimit të miratuar nga Asambleja.

5. Për garantimin e furnizimit, Furnizuesi i Shërbimit Universal dërgon te shoqëria publike e prodhimit programe mujore, javore dhe ditore për mbulimin e kërkesës me energji elektrike për klientët universalë, sipas parashikimeve të kontratës së miratuar nga ERE.

6. Shoqëria publike e prodhimit ka të drejtë që t'i shesë energji Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për furnizimin e kategorive të caktuara të klientëve të dalë në treg të lirë, sipas çmimit dhe sasisë së përcaktuar nga Asambleja e shoqërisë. Në rastin kur Furnizuesi i Mundësisë së Fundit ushtrohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, kjo marrëdhënie pasqyrohet në kontratën që kanë palët, sipas pikës 4, të këtij neni.

7. Sasia e tepërt mujore e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria publike e prodhimit, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve universalë, në përputhje me parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve të vendosura në pikën 4, të këtij neni, si dhe pas ezaurimit të sasisë së energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë në periudhat pararendëse i shitet Furnizuesit Publik të Tregut të Lirë, për llogari të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për mbulimin e humbjeve, me çmimin e blerjes së energjisë së prodhuesve me përparësi hidrike. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet. Kontrata ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Furnizuesit Publik në Tregun e Lirë negociohet nga palët dhe miratohet nga ERE.



Neni 6

Çmimi i rregulluar për furnizimin e klientëve nga Furnizuesi i Shërbimit Universal

1. Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të furnizojë klientët e energjisë elektrike, me çmim të rregulluar dhe të miratuar nga ERE, në përputhje me nenin 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, çmim i cili duhet të pasqyrojë kostot.

2. Pasqyrimi i kostos bëhet duke përfshirë koston e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria publike e prodhimit, që përmban edhe kostot financiare të TEC Vlora sh.a., koston për tarifat e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, koston e furnizimit, si dhe koston e detyrimit të blerjes së energjisë nga burimet e rinovueshme, në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së tarifës së miratuar nga ERE.

Neni 7

Klientët në nevojë

Klientët familjarë, që kanë fituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 95, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, kanë të drejtën e përfitimit të Shërbimit Universal të Furnizimit, sipas kushteve të veçanta të furnizimit, të cilat miratohen nga ERE.

Neni 8

Furnizimi i klientëve me status të veçantë

1. Furnizuesi i Shërbimit Universal, në kuadër të detyrimit të shërbimit publik, siguron pa ndërprerje furnizimin e klientëve, si më poshtë:

a) subjektet shtetërore, që sigurojnë shërbimin e shëndetit publik (spitalet dhe qendrat e urgjencës);

b) shoqëri, që sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve;

c) institucione shtetërore të ekzekutimit të vendimeve penale dhe institucione shtetërore, të cilat mbulojnë sigurinë kombëtare dhe rendin publik.

2. Klientëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, i sigurohet furnizim i pandërprerë edhe në rast se kanë dalë në treg të liberalizuar dhe furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit,

sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 9

Detyrimi për lidhjen në rrjet

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i detyruar të përmirësojë dhe zgjerojë sistemin e shpërndarjes, me qëllim sigurimin e lidhjes së çdo klienti fundor, i cili nuk është i lidhur në sistemin e shpërndarjes, nën termat, kushtet dhe tarifat e vendosura nga ERE.

2. Pavarësisht detyrimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të ketë detyrimin për të ndërtuar apo zgjeruar sistemin e shpërndarjes në një zonë, në të cilën nuk ka ekzistuar rrjet, para vendosjes së këtij detyrimi të shërbimit publik, përveç në zonat, të cilat janë pjesë e një plani territorial, kombëtar ose lokal, të miratuar në përputhje me parashikimet e legjislacionit specifik për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 10

Cilësia e shërbimit

1. Standardet e cilësisë së furnizimit, duke përfshirë kërkesat e nevojshme të vazhdimësisë së furnizimit në një nivel të qëndrueshëm të tensionit, që duhet të plotësohen nga të licencuarit që kryejnë aktivitetet e gjenerimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit, duke përfshirë ofruesin e shërbimit universal, të përfshira në rregulloret dhe kodet ekzistuese, do të konsiderohen detyrime të shërbimit publik, të vendosura sipas këtij vendimi.

2. Kushtet e cilësisë së furnizimit, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, në lidhje me secilin prej të licencuarve, do të miratohen nga ERE, duke marrë për bazë edhe standardet evropiane të shërbimit të furnizimit.

Neni 11

Siguria e furnizimit

1. Çdo detyrim i vendosur ndaj një të licencuari, që kryen aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes ose furnizimit të energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e sigurisë së furnizimit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, do të



konsiderohet detyrim i shërbimit publik dhe do të trajtohet sipas dispozitave të këtij vendimi.

2. Çdo investim i bërë nga shoqëria publike e prodhimit, për kapacitete të reja gjeneruese, në funksion të plotësimit të kërkesës së klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, do të trajtohet si një detyrim i shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit.

Neni 12

Burimet e rinovueshme të energjisë

1. Çdo detyrim i vendosur ndaj të licencuarve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në lidhje me burimet e rinovueshme të energjisë, do të konsiderohet detyrim i shërbimit publik.

2. Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE. Shoqëria publike e prodhimit ka të drejtë të lidhë kontratë blerjeje të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme që shërbejnë për diversifikimin e prodhimit e saj.

3. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, deri në krijimin e operatorit të energjisë së rinovueshme dhe krijimin e tregut të ditës në avancë, do ta tregtojë këtë energji për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, me të njëjtin çmim me të cilin e blen këtë energji nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, deri në përfundimin e kontratave të shitblerjes së energjisë.

4. Në rast të tepricave të krijuara nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, ato depozitohen te shoqëria publike e prodhimit, për t'u përdorur për nevojat e furnizimit të klientëve universalë. Këto sasi rakordohen me bazë mujore dhe shkëmbehen gjatë vitit për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes bazuar në sasinë dhe programet e kërkuara nga Furnizuesi i Tregut të Lirë dhe rëna dakord ndërmjet palëve, deri në mbulimin e plotë të humbjeve. Shoqëria publike e prodhimit kompenzon Furnizuesin e Tregut të Lirë në vlerë, për sasinë e depozituar dhe që nuk është shkëmbyer deri në fund të vitit kalendarik, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike. Teprica e burimeve të

rinovueshme të depozituara dhe që nuk përdoren për mbulimin e humbjeve mund të shiten në treg të lirë nga prodhuesi publik. Kjo marrëdhënie rregullohet në kontratën dypalëshe ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë, dhe mban në konsideratë rregullat e tregut të balancimit në fuqi.

5. Në rast të mosigurimit të energjisë për mbulimin e humbjeve të prodhuar nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike apo nga shoqëria publike e prodhimit, siç përcaktohet në pikën 7, të nenit 5, të këtij vendimi, dhe pikës 4, të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta sigurojë këtë energji në treg të parregulluar nëpërmjet Furnizuesit publik në Tregun e Lirë, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike të miratuar me vendim të Entit Rregullator të Energjisë. Në këtë rast, energjia e blerë për mbulimin e humbjeve nuk konsiderohet si energji që shkëmbehet për efekt të përlllogaritjes së tepricave të burimeve të rinovueshme.

Neni 13

Gjendja e emergjencës në furnizim

1. Gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim, shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Operatorin e Sistemit të Transmetimit me të gjithë sasinë e nevojshme, për mbulimin e humbjeve, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike. Kontrata ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, negociohet nga palët dhe miratohet nga ERE.

2. Kontrata ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit do të përfshijë detyrimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për të dërguar te shoqëria publike e prodhimit programe vjetore, mujore, javore dhe ditore, për mbulimin e kërkesës me energji elektrike, për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.



PJESA III
DISPOZITA TË TJERA DHE TË FUNDIT

Neni 14
Monitorimi dhe raportimi

1. ERE monitoron zbatimin e detyrimeve të shërbimit publik nga ana e të licencuarve përkatës, sipas këtij vendimi, termave, kushteve dhe licencave përkatëse.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ERE informojnë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për të gjitha masat e vendosura për përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, sipas këtij vendimi, ndikimin e tyre të mundshëm në hapjen e tregut të energjisë dhe nëse këto masa janë në përputhje me direktivën 2009/72/EC.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ERE njoftojnë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë periodikisht, të paktën çdo dy vjet, për çdo ndryshim të kushteve për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 15
Dispozita kalimtare

1. Këto kushte, për aq sa janë të zbatueshme, do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në bërjen funksionale dhe likuide të bursës së energjisë.

2. Ngarkohen shoqëritë KESH sh.a., FSHU sh.a., OSSH sh.a. dhe FTL sh.a., që me hyrjen në fuqi të këtij vendimi të rakordojnë sasitë e energjisë elektrike të depozituar/shkëmbyer përgjatë vitit kalendarik, sipas të dhënave faktike të periudhës së rakordimit.

3. Enti Rregullator i Energjisë, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto kushte.

VENDIM
Nr. 458, datë 29.6.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 160, DATË 19.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE TË NËPUNËSVE CIVILË (FONDI I EKSELENCËS)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 4, e 112, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 459, datë 29.6.2022

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR ZYRËN VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR SHKODËR, NGA AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, TË PASURISË SË PALUAJTSHME NR. 2/973-N27, NË ZONËN KADASTRALE 8591

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pasurisë së paluajtshme të llojit “njësi”, me numër 2/973-N27, në zonën kadastrale 8591, Shkodër, me sipërfaqe 436 (katërqind e tridhjetë e gjashtë) m², sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe fragmentit të hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij (lidhja nr. 1).

2. Pasuria e paluajtshme, pas kalimit në përgjegjësi administrimi, përdoret në funksion të qëllimit të veprimtarisë së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër.

3. Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pasurisë së paluajtshme, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Shkodër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Lidhja nr.1

Ministria e Arsimit dhe Sportit, Dato 7.11.1994 **KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME** Vol. 37, Fq. 194

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE
Zona Kadastrale: 8591 NR.I PASURISE: 2/973-N27 --> Vizion nga Vol. , Fq. :
Indeksi i Hartes: SH-N-7 Vizion në: Vol. , Fq. : deri në: Vol. , Fq. :
Adresa e Pasurisë: Rrethi SHKODËR Q/F SHKODËR **PERFUNDIMTARE (data):**
Rr/L. P/G SH K Ap

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE
Lloji i Pasurisë: NJESI Brenda V.K.N.: PQ, Ref. EL, RREGULL, UES
Sip. Totale e Pasurisë: Nga Sip. Totale: sa Truall: Nga Sip. Truall: sa Ndërtuesi
1. 436.00 m² 1. m² 1. m² Per pjesën e përfaqshkët:
Ref. 00006849 Ref. Ref. **PALLAT**
2. m² 2. m² 2. m² Kuota e pjesëmarrjes:
Ref. Ref. Ref. 1.00 %
3. m² 3. m² 3. m² Nr i Pasurisë (pallat):
Ref. Ref. Ref. 2/973
4. m² 4. m² 4. m² Vol 23 Faqe 48
Ref. Ref. Ref.

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësin	Mbiemri	Nr. Pasap	I/V/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00006851	14/12/2004	ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME				1	TIRANE	44,848,587	14/12/2004	K.SHTUTJE NR. REP. 1346 NR. KOL. 953 DT. 14.12.2004	



**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME SHKODËR
 Adresa: Lagjia Oemal Stafa, Prapa Universitetit Luigj Gurakuqi, Shkoder
 SHKODËR, mbl _____ 4 _____ 2022
 SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone
 Në regjistrin Vol _____, Faqe _____, Zona Kadastrale _____, Qyteti Shkoder

REGJISTRUESI
 BLERINA TUZI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 8591

KODI UNIK: 8591037194

NUMRI PASURISË : 2/973-N27

INDEX I HARTËS: SH;M-7

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:500

DREJTORI
(Emer Mbiemer)

Data e lëshimit: __/__/__

SHPJEGUES
□ PARCELA
■ NDERTESA

**KORRIGJIM GABIMI MATERIAL**

Në vendimi e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, “Mbi miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe afatet, për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 196, datë 20.12.2021, bëhet korrigjimi si më poshtë vijon:

Neni 7, pika 2, germa “d”:

Ishte:

“marrëveshje paraprake e nënshkruar me bankën, në rastet e barrësimit, hipotekimit etj., të kuotave/aksioneve;”.

Bëhet:

“marrëveshje paraprake e nënshkruar me bankën, në rast se ka;”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë